



**BASHKIA E TIRANËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

**Nr. 26 Datë 13.08.2015**

**PËR “DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.3 DATË 05.02.2007 “PËR  
SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 15, nenit 16 dhe nenit 32, shkronja “F” të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2007 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), ligjit Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKK Petrelë nr.5, datë 16.01.2015, VKK Farkë nr.19, datë 16.03.2015, VKK Dajt nr.2, datë 02.02.2015, VKK Zall- Bastar nr.19, datë 19.03.2015, VKK Bërzhitë nr.8 dhe nr.9, datë 30.01.2015, VKK Krrabë nr.7 dhe nr.8, datë 25.03.2015, VKK Baldushk nr.7, datë 09.02.2015, VKK Shëngjergj nr.6, datë 20.02.2015, VKK Vaqar nr.42, datë 12.12.2014, VKK Kashar nr.58, datë 20.12.2014, VKK Pezë nr.1, datë 27.01.2015, VKK Ndroq nr.10, datë 26.01.2015, VKK Zall Herr nr.13, datë 24.03.2015, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimet në VKB nr.3, datë 5.2.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), si vijon:
  - 1.1. Paragrafi i fundit i pikës 1.1 “Taksa vendore”, nëndarja a.1 “Taksa mbi ndërtesën”, ndryshon si më poshtë:

*“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë I “Ndërtesa Banimi”, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me “Njësitë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.*

---

**1.2.** Paragrafi i fundit i pikës 1.1 “Taksa vendore”, nëndarjes a.2 “Taksa mbi tokën bujqësore”, ndryshon si më poshtë:

*“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.*

**1.3.** Në pikën ë, “Taksa Për Zënien e Hapësirave Publike”, të pikës 1.1, “Taksa vendore”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. PAGESA E TAKSËS PËR ZËNIE TË HAPËSIRËS PUBLIKE”, ndryshon si më poshtë:

Pika a, ndryshon si më poshtë:

*“Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme , struktura e ngarkuar për mbledhjen është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, pas marrjes së Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, e cila do të jepet nga struktura përkatëse që jep lejet për ushtrim aktiviteti në Bashkinë e Tiranës. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse”.*

Pika b, ndryshon si më poshtë:

*“Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar në Tregjet Publike të Tiranës, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.*

b. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënien e hapësirës publike, ndryshon si më poshtë:

*Për nënkategorinë (a) Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (b) Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”, në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”*

**1.4.** Në germën ë, “Tarifa për Njësitë Bashkiake” të pikës 1.2 “Tarifat Vendore”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Titulli i pikës ë, “Tarifa për Njësitë Bashkiake”, ndryshon në “Tarifë për Njësitë Administrative Nr. 1-11”:

b. Paragrafi i fundit i kësaj pike ndryshon si më poshtë:

*“Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së shërbimit në tregjet publike është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative sipas vendndodhjes së secilit treg. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë”.*

**2.** Të miratojë përfshirjen në paketën fiskale tranzitore të Bashkisë së Tiranës, paketat fiskale të Njësisve Administrative (ish komunave) në bazë të vendimeve të Këshillave të Komunave përkatëse, sipas anekseve bashkëlidhur 1 -13, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

---

3. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore sipas pikës 2, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative sipas vendndodhjes së secilit treg. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Tiranës dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financës dhe Njësitë Administrative.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

**ALDRIN DALIPI**

---

## ANEKS NR.1

### NJËSIA ADMINISTRATIVE PETRELË

- Takse Fjetje Ne Hotel		deri ne 5% te cmimit per nje nate ne hotel
- Takse Rregjistrimi e Pervitshme e Automjeteve sipas ligjit nr.8982, date 12/12/2002		
- Takse Tabele		120 lek/ne vit
- Takse Tabele Per Qellime Reklamimi (te thjeshta dhe elektronike) per m <sup>2</sup>		13.500 lek/ne vit
- Tarifë pastrimi për biznesin e madh		50.000 leke
- për bar-restorante	30.000 leke	Tarifë pastrimi
- për servis	20.000 leke	Tarifë pastrimi
- Tarifë pastrimi për tregtim me pakicë		15.000 leke
- Tarifë pastrimi për bar-kafe		15.000 leke
- Tarifë pastrimi për tregtim me shumicë		30.000 leke
- Tarifë pastrimi për tregtim Ambulant		1.500 leke
- Tarifë pastrimi familjari për cdo person në vit		400 leke
- Tarifë për zënie hapësire për qëllime biznesi (Ilog.përm ) në vit		50 leke

---

## ANEKS NR.2

### NJËSIA ADMINISTRATIVE FARKE

- a-** Tatimi i Thjeshtuar Mbi Fitimin  
Sipas ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" I ndryshuar, dhe Udhezimit të Ministrit të Financave nr.32 date 31.12.2013" Per Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogel").
- b-** Taksën Mbi Pasurinë e Paluajtshme (sipas ligjit) në të cilën përfshihen:  
-Taksa mbi ndertesën  
- Taksa mbi token bujqesore
- c-** Taksa e Fjetjes në Hotel në masën 3% të cmimit të fjetjes në hotel.
- d-** Taksa e Ndikimit në Infrastrukture nga Nderimet e Reja përcaktohet si më poshtë:  
-  
e masën 3% të vlerës së investimit për çdo lloj zhvillimi ndertimor. N
- e-** Taksa Mbi Kalimin e Të Drejtës së Pronësive Mbi Pasuritë E Pa Luajtshme, sipas tabelës aneks i ligjit.  
- P  
er shitje trualli dhe toke bujqesore në masën 2% të vlerës së shitjes.
- f-** Taksa e Rregjistrimit të Automjetit të Perdorur  
(sipas tabelës aneks I , që vilet nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor) në masën 18% të vlerës së arketuar mujore mbasi është zbritur 5% në favor të DSHTRR.
- g-** Taksa Per Zenien E Hapsirave Publike 60 lek/m<sup>2</sup> në muaj
- h-** Taksa e Tabeles  
-Per tabela identifikuese 120 lek në vit.  
-Per tabela reklamuese 13.500 lek/m<sup>2</sup> në vit.

### TARIFA E PASTRIMIT

- |   |   |                 |
|---|---|-----------------|
| - | Per cdo familje   |                 |
|   | 3.600 lek /vit  |                 |
| - | Per sh.p.k ndertimi   | 100.000 lek/vit |
| - | er sh.p.k prodhimi  | 50.000 lek/vit  |
| - | Per sh.p.k tregtare që zhvillojnë aktivitetin në një sipërfaqe                                    |                 |
|   | deri 100 m <sup>2</sup>   | 20.000 lek,     |
|   | 100 deri 200 m <sup>2</sup>   | 30.000 lek,     |
|   | 200 deri 300 m <sup>2</sup>   | 40.000 lek,     |
|   | 300 deri 400 m <sup>2</sup>   | 50.000lek,      |
|   | 400 deri 500 m <sup>2</sup>   | 60.000 lek,     |
|   | 00 deri 1000 m <sup>2</sup>   | 100.000 lek.    |
|   | mbi 1000 m <sup>2</sup> tarifa e pastrimit  | 150.000 lek.    |
| - | Per shpk sherbimi dhe artizanale  | 20.000 lek/vit. |
| - | Per shpk me adrese të selisë në Njesinë Farke por që nuk zhvillojnë aktivitet në territorin e saj | 20.000 lek/vit. |
| - | Per biznes i vogël bar-kafe, bulmet,mish-peshk, hoteleri, motele dhe të tjera të ngjashme me keto | 20.000 lek/vit. |
| - | Per biznes i vogël prodhues   | 20.000 lek/vit. |

- Per biznes i vogel sherbimi, artizanati, artikuj te ndryshem industriale, ushqimore dhe ambulant 5.000 lek/vit.
- er biznes i vogel ushqimore 10.000 lek/vit

P

#### **TARIFA PER CDO BAGETI TE THERUR.**

- Per bageti te trasha 500 lek/koke.
- Per bageti te imta 200 lek/koke.

**TARIFA PER MBAJTJEN E QENVE TE LUKSIT** 11.000 lek /vit.

**TARIFE PER LEJE GJUETIE DHE PESHKIMI** 2.000 lek/vit.

**TARIFA PER DHENIE VERTETIMI PER SHITJE TOKE** 100 lek/m2.

#### **TARIFE PARKIMI AUTOMJETESH**

- 100 leke/dite per autovetura
- 200 leke per mjet tjera
- 20.000 lek/vit per rezervim vend parkimi ne prone publike.

#### **TARIFA SHERBIMI PER URBANISTIKEN.**

- Tarife per urbanizimin e zones dhe sistemimin e mbetjeve inerte ne masen 2 % te vleres se investimit per ndertime per qellime tregtie perjashto rastet e parashikuara ne vendimin nr.61 dt.26/12/2012 te Keshillit te Komunes Farke.
- Tarife per pranim dhe protokollim dosje per aplikim leje zhvillimore ndertimi 10.000 lek.
- Tarife per terheqje dokumentash dhe njesim me origjinalin 1.000 lek/flete
- Kontroll te sistemimit te ambientit rrethues pas perfundimit te punimeve, sherbimi per akt-kontrolli, piketimi te objektit 10 lek/m2
- Tarife Sherbimi per akt-kontrolli, piketimi te objektit 10 lek/m2
- Tarife Sherbimi per akt perfundimtar te kontrollit dhe leshimit te lejes perdorimit 20 lek/m3 te objektit
- Tarife rilevim shesh zhvillimi 30 lek/m2.
- Tarife per gatitje planimetrie nga topografet e komunes si me poshte:
  - a. Per siperfaqe 1 deri 1.000 m2 pagesa eshte 5.000 leke.
  - b. Per siperfaqe 1.001 deri 5.000 m2 pagesa eshte 8.000 leke
  - c. Per siperfaqe mbi 5.000 m2 pagesa eshte 0.5 lek / m2
- Tarife per ujin e pijshem per popullaten dhe 5 lek/m3 tarife sherbimi ose 400 lek/fryme pa tvsh. 45 lek /n-13
- Tarifa e ujit te pijshem per entet private do te jete dhe 15 lek/m3 tarife sherbimi. 13 5 lek/m3 pa tvsh
- Tarife per lidhje kontrate te ujit te pijshem 8.000 leke/familje

- (perfshihet aparati mates) dhe 20.000 leke per BV
- Tarife sherbimi per grumbullimin dhe largimin e ujrave te zeza 500 l/vit per cdo familje dhe 50.000 leke per BM
  - Tarife azhurnim K.U.Z. dhe ujesjellesin 5.000 leke
  - Tarife sherbimi per varreza publike 25.000 leke/rast
  - Tarife ndricimi dhe gjelberimi rrugor 1.200 leke/familje ne vit
  - Tarife hipotekim banese 10.000 per cdo rast

## ANEKS NR.3

### NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJT

#### 1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

Sipas ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" I ndryshuar, dhe Udhezimit te Ministrit te Financave nr.32 date 31.12.2013" Per Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit te Vogel").

#### 2. TAKSA MBI PASURITE E PALUAJTESHME

##### 2.1 TAKSA MBI NDERTESAT (m2 ne vit)

Kategorite minimale te ndertesave	Leke/m <sup>2</sup> ne vit Zona Tirane
I. Ndertesa banimi	
- ndertuar para 1993-shit	7.5
- ndertuar gjate dhe pas 1993-shit	11
II. Ndertesa te tjera	
- per tregti dhe sherbime	100
- te tjera	25

##### 2.2 TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE leke/hektar/vit

Kategorizimi i tokave bujqesore te fshatrave te Njesise Administrative Dajt sipas te dhenave te bonitetit;

Nr.	Fshati	Kategoria	Vlera leke/ ha
1	Tufine	IV	3600
2	Ferraj	V	3000
3	Linze	V	3000
4	Surrel	V	3000
5	Lanabregas	V	3000
6	Brare	VI	2400
7	Priske	VI	2400
8	Tujan	VII	1800
9	Selbe	VII	1800
10	Murth	VIII	1800
11	Shkalle	IX	1800

12	Darshen	IX	1800
13	Qafmolle	IX	1800

**2.3.** Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e Takses vendore e biznesit e vogel mbahen nga zyra e tatim taksave.

**2.4** Afati:

- Kesti i pare "Taksa mbi ndertesat/token bujqesore" per cdo person fizik, juridik, fermer apo familje buqesore fillon me vitin e ri dhe perfundon, brenda dates 20 Prill te vitit
- Kesti i dyte "Taksa mbi ndertesat/token bujqesore" per cdo person fizik, uridik, fermer apo familje buqesore fillon me vitin e ri dhe perfundon, brenda dates 20 Gusht te vitit

### **3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL**

Niveli i kesaj takse do te jete 5 (pese) % e cmimit te fjetjes per person.

**3.1** Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e Takses vendore e biznesit e vogel mbahen nga zyra e tatim taksave.

**3.2** Afati: Subjektet e tatimit mbi biznesin e vogel, paguajne taksen ne kater keste ( sipas nenit 14 te ligjit Nr. 9632, date 30.10.2006), kesti i pare brenda dates 20 Prill, kesti i dyte brenda dates 20 Korrik, kesti i trete brenda dates 20 Tetor dhe kesti i fundit jo me vone se 20 Janar i vitit te ardhshem fiskal.

### **4. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE PER NDERTIMET** e te gjitha llojeve (ndertime te reja dhe rikonstruksione)

**4.1** Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja per banim deri tre kate te jete 1( nje) % e vleres se investimit (Preventivi i ndertimeve qe maten me meter katror nuk duhet te jete me i vogel se vlera qe del nga shumzimi siperfaqes me cmimin njesi te miratuar nga organet tatimore). Per elemente shtese ne funksion te nderteses si pishina, rrethime dekorative,kabine elektrike, ujesjelles privat,shatervane etj investitori duhet te paraqese preventiv te vecante me cmime sipas manualit te cmimeve te vitit 2014 mbi bazen e te cilit do te llogaritet taksa shtese e ndikimit ne infrastrukture prej 1( nje) %

**4.2** Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja mbi tri kate mbi Coke) eshte 3 ( tre) /% e vleres se investimit (preventivi i ndertimeve qe maten me meter katror nuk duhet te jete me i vogel se vlera qe del nga shumzimi i siperfaqes me cmimin njesi te miratuar nga organet tatimore).

Per elemente shtese ne funksion te nderteses si pishina, rrethime dekorative,kabine elektrike, ujesjelles privat,shatervane etj investitori duhet te paraqese preventiv te vecante me cmime sipas manualit te cmimeve te vitit 2014 mbi bazen e te cilit do te llogaritet taksa shtese e ndikimit ne infrastrukture prej 3( tre) /%

**4.3** Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertime qe perfshihen ne rikonstruksionin e objekteve te ndryshme (pavaresisht numrit te kateve apo llojit te ndertimit) do te jete 2(dy)%



**4.4** Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet ne objektet infrastrukture si ujesjellesa, kanalizime linja elektrike, telefonie, telferiku, kabina elektrike, rruge etj te kryera nga subjektet fizike apo juridike private dhe/ose publike te jete 1( nje) % ( nje perqind) e vleres se investimit sipas preventivit.

**4.5** *Taksa/Detyrimi per studime urbanistike* eshte 1% ( nje perqind ) e vleres se preventivit per te gjitha llojet e ndertimeve perfshire dhe ndertimet e infrastruktures si si ujesjellesa, kanalizime linja tensioni, telefonie, kabina elektrike, rruge , linja teleferiku, linja hekurudhore etj etj ( preventivi i ndertimeve(ndertesa) qe maten me *meter katror* nuk duhet te jete me i vogel.

Cdo subjekt qe kryen ndertime, vec vleres se takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja sipas percaktimeve te paragrafit 1,2, 3 e 4 te kesaj pike (4 ) do paguaje taksen e studimeve urbanistike prej 1( nje) % te vleres se investimit, para marrjes se lejes se ndertimit).

**4.6** Taksa/Detyrimi per studime urbanistike per ndertime qe perfshihen ne rikonstrukcionin e objekteve te ndryshme (pavaresisht numrit te kateve apo llojit te ndertimit) do te fete 0 (zero)%

**4.7** Per ndertimet e reja apo te perkoshme, qofte edhe ato per infrastrukture, me kontributin e organizmave te huaja, fondacioneve e organizatave jofitimprorese, qe i sherbejne interesit publik, perballimit te emergjencave civile te shkaktuara nga fatekeqesi natyrore dhe nga faktor te tjere madhor, qe i sherbejne perballimit te nevojave emergjente dhe ne vijimesi per njerzit ne nevoje, te paguhet , per llogari te studimeve urbanistike vetem 1(nje)% e vleres se investimit. (Preventivi llogaritet mbi bazen e Kosmos Minimale fiskale per ndertimet qe llogaritet gel° vit nga Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve dhe Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise, per objektet infrastrukture sipas preventivit me cmime te miratuara sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi).

**4.8** Per rastet kur leja e ndertimit miratohet dhe jepet nga strukturat rajonale/qendrore, per objekte te reja (nen dhe mbi tre kate),ndertimet e infrastruktures si ujesjellesa, kanalizime linja tensioni, telefonie, kabina elektrike, rruge, linja teleferiku, linja hekurudhore etj. dhe me siperfaqe sheshi apo ndertimi qe ndodhen ne territorin e Njesise, qe eshte ne kompetence te tyre, te paguhet pa diferencim 3% ( tre perqind ) e vleres se preventivit si takse e ndikimit ne infrastrukture per llogari te pushtetit vendor nga investitori. Autoriteti qe zbardh e jep lejen e ndertimit per keto raste, para dhenies se lejes se ndertimit investitori detyrimisht duhet te derdhe per llogari te Bashkise se Tiranes kete vlere financiare (sipas nenit 27 te ligjit Nr.9632, date 30.10.2006).

**4.9** Taksa e ndikimit ne infrastrukture dhe Taksa/Detyrimi per studime urbanistike derdhet ne llogarine e Bashkise se Tiranes me vlere te plote(ne rast se veprohet me banke komisioni bankar nuk perfshihet ne kete vlere) .Ne kohen kur evidentohet derdhja behet zbardhja e Lejes se Ndertimit

**4.10** Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e Takses se ndikimit ne infrastrukture dhe Takses/Detyrimin per studime urbanistike mbahen nga Zyra e Urbanistikes

## **5. TAKSA E TABELES**

---

1) taksa e tabelës për qelime identifikimi	Niveli i takses
<p>a) Tabele, për qelime identifikimi, pavaresisht nga sipërfaqja, të trëzuar në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tjerëve. Në të kësaj tabele vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>b) Tabela për *Time identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.</p>	120 leke/në vit
<b>2) Tabele për qelime reklamimi të thjeshta dhe elektronike</b>	
Për bashkitë e tjera dhe komunitat	13,500 leke m <sup>2</sup> /vit deri në sipërfaqen 18 m <sup>2</sup> . . Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m <sup>2</sup> paguhet 243 000 leke/vit.
3) Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, 1000 stenda reklamuese, banderola etj.	1.000 leke m <sup>2</sup> /ditë

## 6. TAKSA PËR ZENIEN E HAPSIRAVE PUBLIKE

- Për qelime biznesi

60 leke/m<sup>2</sup> në muaj

## 7. TAKSE GJËTIE

750 leke/në vit

8. **TAKSA E QERASE është 3%** ( tre përqind ) e vlerës së pagesës mujore, e cila paguhet nga qiradhenesi, për objektin tokë bujqësorë/ kullot/livadh/truall, apo për çdo lloj objekti ndërtimi, qofte dhe i perkohshëm.

9. Plotësimi i formulareve dhe evidencat për derdhjen takses së tabelës ,takses për zenien e hapësirave publike për qelime biznesi, takses së gjetisë dhe takses së qerases mbahen nga Zyra e Tatimit Taksave.

## 10. Afati:

Subjektet e tatimit mbi biznesin e vogël, paguajnë taksen sipas përcaktimeve të tabelës 5.1, pikave 5.2, në kator keste ( sipas nenit 14 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006), kesti i parë brenda datës 20 Prill, kesti i dytë brenda datës 20 Korrik, kesti i tretë brenda datës 20 Tetor dhe kesti i fundit jo më vonë se 20 Janar i vitit të ardhshëm.

Taksa së gjetisë dhe taksa e qerases mbahen. mbahen menjëherë sa paraqitet dokumentacioni ose kërkesa përkatëse.

## TARIFAT VENDORE

### 1. TARIFA VENDORE E PASTRIMIT

## **1.1 Kategoria A**

Kategorite e meposhtme per taksen e pastrimit do te kene detyrimin si vijon:

1.1.1. Subjektet e Karrierave per prodhim gun dhe inerte	100.000 leke
1.1.2. Subjektet e biznesi te vogel	10.000 leke
1.1.3. Subjektet e biznesit te madh	40.000 leke
1.1.4. Subjektet e biznesit te madh kategoria (VIP,)	100.000 leke
1.1.5. Sherbime shendetesore, artizanale e komunale (Biznes i Vogel)	2.500 leke
1.1.6. Per ambulantet	1.500 leke
1.1.7. Per institucionet arsimore, kulturore e socile (Biznes i Madh)	35.000 leke
1.1.8. Per cdo familje te lagjes Qesarak te fshatit Linze, te Iagjes Shimaj te fshatit Tufine	1.000 leke

## **1.2 Kategoria B**

Kategorite e meposhtme per taksen e pastrimit do te kene detyrimin si vijon:

1.2.1 Pensionistet	500 leke/vit
1.2.3. Veteranet	0
1.2.4. Invalidet e punes dhe te luftes	0
1.2.5. Perfituesit e ndihmes ekonomike	500 leke/vit
1.2.6. Te verberit	0
1.2.7. Te semuret paraplegjik dhe tetraplegjik	0

**1.2.8** Kategorite e mesiperme pika (1.2.1),(1.2.3),(1.2.4),(1.2.5),(1.2.6) perjashtohen dhe nga pagesa e tarifave te tjera, te percaktuara ne piken 5/1/1 ,dhe 5.1.2 (shif "Tarifa per sherbime te kryera nga: " Tarifa per sherbime te kryera nga: Zyra e administrimit dhe mbrojtjes se tokes"

**1.1.9** Kategorite sipas pikave pika (1.2.1),(1.2.3),(1.2.4),(1.2.5),(1.2.6), pagimin/mospagimin e ketyre tarifave do te bejne me kushtin qe te jene kryefamiljare dhe pa persona te tjere madhore, duke provuar me dokument statusin/kategorine i eili leshohet nga autoriteti kompetent, pervec bashkeshortit ose bashkeshortes, te vertetuara me certifikaten familjare.

2.

### **E ZAKONSHME**

### **TARIFE REKLAME**

13.500 leke/m2

3. **TARIFA E REGJISTRIMIT PER VEPRIMTARI TE NDRYSHME TREGTARE**

Kjo tarife do paguhet nga te gjitha subjektet fizike e juridike qe kane veprimtari apo qe lidhet me veprimtarine e tyre ne territorin e Njesia Dajt, me seli apo dege/filiale, si me poshte:

3.1. Per ambulantet	500 leke
3.2. Per personat juridik (shpk. etj)	5.000 leke
3.3. Per biznesin e vogel	2.000 leke

4. **TARIFA E GJELBERIMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**

Niveli i tarifes se gjelberimit dhe mbrojtjes se mjedisit te jete:

---

4.1. Per ambulantet	10.000 leke/vit	
4.2. Per biznesin e vogel, si dhe per objektet arsimore, kulturore e sociale private	10.000 leke /vit.	
4.3. Per biznesin e madh me seli dhe qe ushtron aktivitet apo qe ka dege/filale apo objekte qe lidhen me veprimtarine e tyre ne territorin e Njesia Dajt	10.000 leke/vit	
4.4. Per cdo subjekt juridik/fizik qe depoziton mbetje urbane ne vendin e miratuar per depozitim e mbetjeve urbane	50 leke/m3.	
I.		A
fati: - Per tarifen e gjelberimit, afati i pageses 3 mujori i pare i vitit.		
II.		P
er tarifen e pastrimit, afati i pageses jo me vone se 30 Marsi i vitit		
III.		P
er tarife reklame e zakonshme pasgesa behet menjehere mbas kerkeses me shkrim		
IV.		P
er tarifen e regjistrimit per veprimtari te ndryshme tregtare behet menjehere mbas kerkeses me shkrim		
V.		P
er tarifen e gjelberimit dhe ruajtjes se mjedisit afati i pageses deri ne fund te 3 mujorit te pare te vitit pasardhes		
VI.		P
lotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen tarifes se pastrimit, tarifes per reklame te zakonshme, tarifes se regjistrimit per veprimtari te ndryshme tregtare, tarifes se gjelberimit dhe mbrojtjes se mjedisit mbahen nga Zyra e Tatim Taksave		

## 5. **TARIFA PER SHERBIME TE KRYERA** nga:

### **Zyra e administrimit dhe mbrojtjes se tokes**

5.1 Dhenie certifikate te levizjes se prodhimeve blektorale	100 leke per cdo rast.
5.2 Dhenie vertetime te zakonshme	100 leke per cdo rast.
5.3 Praktika per plotesimin e dokumentacionit prej regjistrim prone ZRPP-Qark dhe dokumentave perkatese shoqeruese per organet kompetente shtetore per cdo plan rilevimi	1000 leke
5.4 Kopje te njesuar me orgjinalin te " Aktit te manjes se Tokes ne pronesi apo perdorim"si dhe te " Formularit 6":	
a. Kur kerkohet nga qytetaret e interesuar	200 leke per cdo rast
b. Kur kerkohen nga avokati	1500 leke per cdo rast
5.5 Vertetim per shitblerje toke leke/ m2:	
a. Per fshatrat Tujan, Brare, Darshen, Qaf Molle, Selbe, Murth e Shkalle	10 leke/ m2.
b. Per fshatrat Priske , e Surrel (toke are)	50 leke / m2
c. Per fshatrat Priske dhe Surrel (pyll)	20 leke /m2
d. Per fshatin Lanabregas (toke are)	50 leke/ m2
e. Per fshatin Lanabregas (pyll)	20 leke/m2
f. Per fshatin Linze dhe Tufine (toke are)	40 leke/ m2
g. Per fshatin Linze dhe Tufine (toke are)	20 leke/m2

h. Per lagjen Qesarake	50 leke/m <sup>2</sup>
i Per fshatin Ferraj (toke are)	30 leke/m <sup>2</sup>
j. Per fshatin Ferraj (Pyll)	20 leke/m <sup>2</sup>
k. Per hartim dhe konfirmim te GentPlanit te prone /per cdo rast	1.000 leke/ose cope
l. Vertetim per shitblerje brenda trungut familiar si dhe rastet kur toka blihet nga ish pronari	5 leke/m <sup>2</sup>
m. Saktessim kufi prone, proces verbal konflikti	1500 leke /dynymi
n. Konfirmim per prona te pretenduara	2000 leke/dynymi
o. Kthim pergjigje per qytetaret	1000 leke
p. Kthim pergjigje per avokatet	2000 leke

#### 5.6. Tarifa per kontroll mishi

a)	Gjedh
100 leke per koke	
b)	Te imta
50 leke per koke	

#### 5.7 Afatet Per tarifate per sherbime te kryera nga:

"Zyra e administrimit dhe mbrojtjes se tokes" behet menjehere mbas kerkeses 'Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen tarifes se pastrimit,tarifes per reklame te zakonshme, tarifes se regjistrimit per veprimtari te ndryshme tregtare, tarifes se gjelberimit dhe mbrojtjes se mjedisit mbahen nga Zyra e Tatim Taksave.

## **6. PER SHERBIMET NGA ZYRA E URBANISTIKES**

### ***Sherbime gjate marrjes se Lejes se Sheshit dhe Lejes se Ndertimit***

6.2.1-Pranimi i Dosjes per Leje sheshi dhe leje ndertimi	5.000 leke
6.2.2.Pranimi i Dosjes per Leje sheshi ndertimi apo per studime per komplekse banimi me sip. shesh ndertimi mbi 5000 m <sup>2</sup>	20.000 leke
6.2.3.Relievi topografik(azhornimi i faktit plus vendosje te rrugeve ne studim)	15 lek/m <sup>2</sup>
6.2.4.Relievi topografik kur hartohet nga Zyra e Urbanistikës ,hedhja e infrastruktures, rruge dhe infrastruktura nentokesore.	30 lek/m <sup>2</sup>

### ***Sherbime gjate ndertimit te objektit***

6.2.5. Akt kontroll piketimi per te gjitha llojet e ndertimeve	5000 leke
6.2.6. Akt kontroll i kuotes 0.000 per te gjitha llojet e ndertimeve	5000 leke
6.2.7. Akt kontroll i karabinase per te gjitha llojet ndertimeve	2000/ lek per kat
6.2.8. Akt kontroll perfundimtar per te gjitha llojet e ndertimeve.	10 000/ lek per kat
6.2.9. Tarifa per volum	15 leke/m <sup>3</sup>
6.2.10 Per te gjitha sherbimet e mesiperme pika (5.2.5 ),(5.2.6) (5.2.7) (5.2.8 ) (5.2.9 ) per banesat deli 3 (tre) kate(ne kete rast nuk numerohen katet nen toke), tarifa per keto sherbime eshte	3000 leke
6.2.11. Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen tarifes sipas pikave (5.2.1) (5.2.2) (5.2.3 ) (5.2.4) dhe (5.2.5 ),(5.2.6) (5.2.7 ) (5.2.8 ) (5.2.9 ) mbahen nga Zyra e Urbanistikës	
6.2.12 Afatet: Per tarifate per sherbime te kryera" <i>Per Sherbimet nga Zyra eUrbanistikës</i> - Sherbime gjate marrjes se Lejes se Sheshit dhe Lejes se Ndertimit behet	

menjehere mbas kerkeses

## **7. SHERBIMET NGA SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE**

**Sherbime gjate marrjes se lejes se sheshit dhe lejes se ndertimet azhornimi i rrjetit inxhinierik)**

- |   |             |
|---|-------------|
| 7.1. Ujesjellesi - per ndertimet mbi 3 (tre) kate, pallate  | 10,000 leke |
| 7.2. Ujesjellesi per te gjitha ndertimet / banesat nen dhe 3 (tre) kate perfshi dhe ato infrastruktuore | 5,000 leke  |
| 7.3. Kanalizimet per ndertesat mbi 3 (tre) kate   | 10,000 leke |
| 7.4. Kanalizimet per te gjitha banesat nen dhe 3 (tre) kate , perfshi dhe ato te infrastruktures        | 5,000 leke  |
| 7.5. Per banesa nen 3 kate gjate llogaritjes se tarifes nuk merren ne konsiderate katet nen toke        |             |

## **8. SHERBIME GJATE NDERTIMIT TE OBJEKTIT**

- |   |              |
|---|--------------|
| 8.1 Miratim pike lidhje furnizimi me uje per ndertesa (pallate) per objekte qellim biznesi, prodhimi, arsimore, sociale, kulturore, publike dhe private eshte:                          | 300 000 leke |
| 8.2. Per cdo miratim lidhje te furnizimit me uje per ndertesat vetjake per banim deri 3 (tre) kate eshte  | 2 000 leke   |
| 8.3. Per cdo miratim pike lidhje me rrjetin kryesor te shkarkimit te ujrave te zeza per pallatet e lagjes. Qesarak, te fshatit Linze, te lagjes Shimaj, te fshatit Tufine, tarifa eshte | 100 000 leke |
| 8.4 Per cdo miratim pike shkarkimi te ujrave te zeza per ndertesat vetjake per banim den 3 ( tre) kate eshte  | 2 000 leke   |
| 8.5 Per cdo lidhje (celje) kontrate per kantieret e ndertimit eshte   | 20 000 leke  |

## **9. SHERBIME GJATE MARRJES SE LEJES SE PERDORIMIT TE OBJEKTIT**

- |   |              |
|---|--------------|
| 9.1. Proces verbali i kontrollit te lidhjes se furnizimit me uje te pijshem, para lidhjes se kontratave per cdo ndertese te vecuar, per cdo institucion publik ose privat me disa konsumator brenda (paguhet nga sipermarsi)  | 10 000 leke  |
| 9.2. Proces verbali i kontrollit te pikes se shkarkimit te Ujrave te Zeza per cdo ndertese te vecuar, per cdo institucion publik ose privat (paguhet nga sipermarsi)  | 10 000 leke  |
| 9.3. Per te gjitha sherbimet e mesiperme (pika 1,2,3 e 4) per banesa vetjake deri 3 (tre) kate, tarifa per keto sherbime eshte  | 1 000 leke   |
| 9.4. Per subjektin ndertues qe kerkon nga Njesia lidhjen e objektit me rrjetin e furnizimit me uje dhe shtrirjen e kanalizimit te ujrave te zeza mbi 10 ml larg kufirit te njolles se ndertimit ai do te paguaje vleren e investimit sipas projektit te hartuar nga Zyra e Urbanistike plus 5 % to kesaj vlere si tarife projektimi |              |
| 9.5. Marrja e certifikates se Pastertise ne lidhje me respektimin e kerkesave ne pelqimin mjedisor  | 100 000 leke |
| 9.6. Marrja e certifikates se Pastertise ne lidhje me respektimin e kerkesave ne pelqimin mjedisor, per objekte deri /3(tre) kate   | 5 000 leke   |

## **TARIFA E FURNIZIMIT ME UJE TE PIJSHEM**

- |   |                |
|---|----------------|
| 10.1. Per cdo lokal, bar bufe, restaurant e tjera | 5000 lek/ muaj |
|---|----------------|
-

10.2	Per cdo familje te fshatrave te Njesise Dajt	1000 leke/muaj
10.3	Per cdo familje te lagjes Qesarak , tarifa e furnizimit me uje, Kur konsumatori ka mates/ sahat eshte	90 leke per m <sup>3</sup>
10.4	Per cdo familje te lagjes Qesarak , tarifa e furnizimit me uje, kur konsumatori eshte pa mates/sahat eshte	1.2001eke/muaj
10.5	Per cdo kantier ndertimi gjate fazes se ndertimit te objektit	5.000 leke/muaj

**Tarifa per paisje me :**

11.1	Per hapje license transporti	50.000 leke
11.2	Per dhenie certificate transporti	10.000 leke
11.3	Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e tarifes, behet nga Sektori i infrastruktures	
11.4	Afatet Per tarifat per sherbime te kryera per" Sherbime gjate marrjes se lejes se sheshit dhe lejes se ndertimit dhe Lejes se perdorimit behet menjehere mbas kerkeses	

**Tarifa per sherbime te ndryshme**

12.1	Dhenie vertetime te zakonshme .....	100 leke
12.2.	Dhenie dosje objekti (komplet) me konfirmim te njesise me origjinalin	5.000 leke
12.3	Dhenie Vendimit te KRRT-se per leje shesh ndertimi, bashkelidhur formulari '2 dhe me planimetrine e sheshit te ndertimit	200 leke
12.4	Dhenie Vendimit te KRRT-se per Leje ndertimi shocieruar me formularin 4 si dhe me planimetrine e lejes se ndertimit me konfirmim te njesise me origjinalin	200 leke
12.5	Fotokopjime te zakonshme A3 ose A4	50 leke/cdo flete
12.6	Per plotesim vertetimi te shocieruar me Gent plan, planimetri, per njohje pronesie/legalizim etj. te pergatitur nga zyra e urbanistikes	500 leke/cdo rast
12.7	Per dhenie kopje te njehesuar me orgjinalin te lejes se sheshit dhe te ndertimit	250 Leke/cope A4
12.8	Per dhenie kopje te njehesuar me orgjinalin te planimetrise dhe projektit te zbatimit per cdo objekt qe eshte dhene leja e ndertimit	15 leke/ cdo flete

*Ne te gjitha rastet, qe lidhen me taksat e tarifat sipas kettj vendimi, ne siperfaqe apo olum do te perفشihen bodrumet/ parkimet dhe papafingot.*

- 12.9 Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e tarifes behet nga Sektori perkates qe u kerkohet sherbimi.
- 12.10 Afatet per tarifat per sherbime te kryera per behen menjehere mbas kerkeses.

**Tarifa te tjera**

- 13.1 Per cdo kopje dokumenti te njehesuar me orgjinalin e leshuar nga zyra e protokoll arkivit. 100 leke per/ flete A4
- 13.2. Vertetim per qenien banor i Njesise Dajt 100 leke/ cope
- 13.3 Tarifa per cdo reklame ne Gazeten dhe/ ose Revisten " Dajti" 2.000 leke
- 13.4. Tarifa e gjobes per parkimin e makinave ne vendet e ndaluara per pakim 3.000 leke
- 13.5 Plotesimi i formulareve dhe evidencat per derdhjen e tarifes behet nga Sektori perkates qe u kerkohet sherbimi
- 13.6. Afatet: Per tarifat per sherbime te kryera behen menjehere mbas kerkeses
- 13.7. Te gjithë sektoret pergjegjes mbajne evidence te rregullta per cdo derdhje
- 13.8 Mandat pagesat te plotesohen ne Zyren e arkes se Njesise.

**Te tjera**

Per biznesin e vogel dhe te madh qe fillon veprimtari gjate muajeve te vitit, pagesa e tarifave sipas vleres te percaktuar ne kete vendim, do te behet ne propocion me numrin e muajve qe mbeten nga viti, menjehere me fillimin e veprimtarise por jo me vone se data 20 Prill, 20 Korrik dhe 20 Tetor te ketij viti.

Cdo detyrim vjetor i papaguar i taksave dhe tarifave vendore, qe i perket vitit parardhes, sipas nivelit te percaktuar ne vendimin e Keshillit qe ka gene ne fuqi, do te shlyhet nga cdo person fizik, juridik, fermer apo familje buqesore, brenda dates 30 Mars te vitit ne vazhdim.

## **ANEKS NR.4**

### **NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL BASTAR**

#### **I- TAKSE PER MJETET E TRANSPORTIT**

a. Taksi 4+1 vende	8.500 leke/vit (-30%)
b. Taksi 8+1 vende	17.500 leke/vit (-30%)
c. Deri ne 2 ton	14.000 leke/vit (-30%)
d. Nga 2 deri ne 5 ton	20.000 leke/vit (-30%)

#### **II. TAKSE MBI PASURITE E PALUAJTESHME**

##### II.1 Taksa mbi ndertesat

a. Ndertese per tregti dhe sherbime	200 leke/m2
b. Takse per ndertesa te tjera	50 leke/m2
c. Takse per ndertese banimi ndertuar para vitit 1993	7.5 leke/m2
d. Takse per ndertese banimi ndertuar pas vitit 1993	15 leke/m2

##### II.2 Taksa mbi token bujqesore

a. Toke bujqesore e kategorise VI-te ,	2.400 leke/ha (-30%)
b. Toke bujqesore e kategorise VII-te ,	1.800 leke/ha (-30%)

#### **III. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE DHE NDERTIMET E REJA**

a. Per objekte banimi	1% e vleres se investimit
b. Per objekte per funksione administrative dhe sherbimi	2% e vleres se investimit
c. Per objekte me qellime publike	2 % e vleres se investimit

IV. **ZENIE E HAPESIRES PUBLIKE** per qellime biznesi 42 leke/m2/muaj

V. **TAKSE TABELLE** e shprehur ne shqip 120 leke/vit

VI. **TAKSE PER USHTRIM AKTIVITET GJUETIE** 1.000 leke/vit

##### **Tarifa Sherbimi administrative infrastrukture**

a. Tarife per dhenie certifikate ushtrim aktiviteti	1.000 leke
---	------------

---



b. Tarife sherbimi ne Njesi (vertetime te ndryshme)	200 leke
c. Tarife per dhenie me qera objekte social-kulturore	2.000 leke/dite
d. Tarife per plotesim dok. rnujore te ndihmes ekonomike	50 leke
e. Tarife per plotesim dok. vjetore te ndihmes ekonomike	100 leke
f. Tarife pastrirni per karjer prodhim guri e inerte	100.000 leke/vit
g. Tarife per lende drusore	2.500 leke/m3
h. Tarife per dru zjarri	500 leke/m3
i. Tarife per nxjerrje rreshire pishe	3.500 leke/kv
j. Tarife per bime medicinal	150 leke/kv
k. Tarife zenie hapesire publike (qera trualli) telefoni e levizshme	335.000 leke/vit

### **Tarifa te inspektoriatit veterinar**

*Leshim raporti thertore per krere*

1. Te imta	100 leke/krere
2. Te trasha	200 leke/krere
3. Per njesi prodhirni, produkte e nenprodukte te qumeshtit	100 leke/toni

### **Tarifa te uiti te pijshem per konsumatorët per vitin 2014**

a- Per konsumatorët familjare	500 leke/muaj
b- Per objektet e sherbimit	2.000 leke/muaj
c- Tarife per hapje kontrate per konsumatorët familjare	3.000 leke
d- Tarife per hapje kontrate per lokale dhe bar-bufe	4.500 leke

### **Tarifat per dhenien e licensave dhe certifikatave, autorizimeve per veprimtarine e transportit rrugor te udhetareve dhe mallrave.**

Nr	Llojet e transportit	Tarifa e lejes ne leke	Tarifa per license, certifikate leke	Gjithsej leke
A.	TRANSPORT UDHETARESH			
1	License per transport udhet. Me taksi (4+1 dhe 8+1) afat 5 vjecar per mjet	2000	20000	22000
2	License per transport udhet. Linje rrethqytetese (afat 5 vjecar) per linje	5000	20000	25000
3	Certificate per transport udhet. Linje rrethqytetese (afat 5 vjecar) per linje	2000	7500	9500
4	License per Agjensi Transporti udhet. Dhe taksi brenda vendit	per license 3000	15000	18000

## ANEKS NR.5

### NJËSIA ADMINISTRATIVE BERZHITE

#### TAKSA

Taksa zenies hapsires publike me qellim biznesi	60 leke/m2 ne muaj
Takse per banesa para vitit 1993	8.25 leke
Takse per banesa pas vitit 1993	16.5 leke
Takse ndertese per qellime biznesi	200 leke/m2/vit
Takse tabele	120 leke/vit
Takse reklame	13.500 leke/m2/vit
Tatim I thjeshtuar mbi fitimin mbi Xhiro 0 – 2 milion	25.000 leke/vit
Tatim I thjeshtuar mbi fitimin mbi Xhiro 2 -8 milion	7.5% e xhiros vjetore
